



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN**  
**DREJTORATI I INSPEKTORATIT**



**DREJTORATI I INSPEKSIONIT**

|                  |   |
|------------------|---|
| <b>Datë :</b>    | <b>02.09.2024</b>                               |
| <b>Referencë</b> | <b>11-344/8</b>                                 |
| <b>Për :</b>     | <b>Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës</b>            |
| <b>Kopje:</b>    | <b>Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës</b>      |
| <b>Kopje:</b>    | <b>Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës</b>      |
| <b>Nga:</b>      | <b>Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit</b> |
| <b>Lënda :</b>   | <b>Raporti i muajit-gusht</b>                   |

## PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit gusht Drejtoria e Inspektoratit ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektorët e tregut- gjatë muajit gusht në fokus kishin inspektimin i lokaleve afariste. Janë realizuar urdhëresa për regjistrim të lokaleve dhe urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste. Në bazë të kërkesave të bizneseve janë realizuar pranime teknik të lokaleve afariste për të ushtruar aktivitetin e tyre biznesor. Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Lipjan, me date 09.08.2024 në sheshin “Adem Jashari” në Lipjan janë kontrolluar shitësit ambulant me ç’rastë janë konfiskuar lodrat të cilët nuk kanë pasur aktivitet biznesor të regjistruara dhe pa prejardhjeje të mallit i cili veprim është në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës (konfiskimi ka vazhduar nga data 30.07.2024).

Po ashtu janë inspektuar disa veprimtari legale dhe ilegale në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” janë identifikuar dhe janë ndaluar disa persona të cilët ushtronin veprimtari ilegale brenda hapësirave të Aeroportit “Adem Jasharit”, të dhënies me qera të veturave për pasagjerët të cilët e frekuentonin Aeroportin.

Kontrollim i vazhdueshëm i tregjeve, në tregun e gjelbër janë urdhëruar të gjithë tregtarët të cilët kanë qenë jashtë hapësirës së tregut ty hynë në hapësirat e tregut, si dhe tregu i mobileve dhe ai i kafshëve.

Inspektori i mjedisit-ambientit- është përgjigjur ankesave të pranuar nga qytetarët në fshatrat Gadime e Epërme, Medvec, Smallushë, Lipjan, Miren. Ankesa ishin për ndotje të hapësirave publike, shtrati i lumenjve me mbeturina të llojit materiale inerte. Në secilin ankesë është konstatua gjendja dhe janë dhënë urdhëresa ndotësve për largimin e mbeturinave nga vendi i hedhjes. Është bërë ri-kontroll tek vendet e inspektuara, janë zbatuar urdhëresat e dhëna sipas afateve ligjore.

Ankesa tjera kishte për rrjedhje të ujërave në banesa në bashkëpronësi si pasoj e defekteve të gypave.

Janë inspektuar deponit ilegale të mbeturinave në disa fshatra, për të marrë masa ligjore ndaj atyre që takohen duke hedhë mbeturina apo gjenden dëshmi të atyre që kanë hedhë mbeturina.

Është bërë kontroll tek kompleksi shumë banesor dhe afarizëm që është duke u ndërtuar në rr. “Haxhi Kleçka” në Lipjan në lidhje me zbatimin e kushteve të LMK-së. Janë gjetur parregullsi, gjatë kontrollës mbeturinat ishin të shpërndara në vendpunishte, dhe jo të vendosura në kontejner i cili ishte prezent. I është dhënë urdhëresë investitorit që të bëhet grumbullimi i mbeturinave dhe ato të vendosen në kontejnerë.

Është inspektuar një biznes në kodrën e Kërçevës (pronë private), i cili dyshohej se është duke ekspluatuar material (prona private). Gjatë kontrollës u konstatua se biznesi nuk ishte duke ekspluatuar material, por ishte duke përgatite terrenin për të ndërtuar objekt afarist, pasi që kishte marrë kushtet ndërtimore nga drejtoria e urbanizmit K. Lipjan.

Inspektorët e trafikut- Janë inspektuar firmat e autobusëve për rendin e udhëtimit, taksitë individual dhe kompanitë taksi. Inspektime të vazhdueshme janë realizuar edhe në ANP-“Adem Jashari”, ku janë bërë inspektimi i radio-taksive që marrin pasagjer pa porosi dhe auto-taksi ilegal. Pjesë e inspektimeve kanë qenë rrugët në qytet dhe në fshatra, për secilën prerje, dëmtim janë marr të gjithë hapat procedural ligjor.

Inspektori i ndërtimit- Përgjatë muajit gusht inspektori i ndërtimtarisë ka inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi në teren, e sidomos përgjatë zonës urbanistike, industriale, ekonomike. Me procesverbal është evidentua dhe konstatuar për të gjitha ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi. Inspektori i ndërtimit raporton që ka marr të gjitha masat ligjore.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjigjur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët qofshin ato në mënyrë të shkruar, elektronike apo përmes telefonatës.

## **PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE**

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit gusht janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste, si dhe janë bërë pranime teknike të lokaleve afariste.

Janë inspektuar lokalet afariste, marketet ku janë kontrolluar çmimet e artikujve ushqimor në rafta dhe çmimet e arkës gjatë pagesës.

Inspektimi i shitësve ambulantiv në sheshin “Adem Jashari”.

Është bërë inspektimi i tregjeve, ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Inspektimi i auto-taksive në qytetin e Lipjanit.

Inspektimi i auto-taksi dhe kombi-taksi ilegal.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

| Inspektorët | Gjithsej inspekte | Inspekte me procesverbal | Pranime teknike | Fletëparaqitje | Njoftime për objektet e legalizuara nga DPUMM-ja | Vendosje të shiritave | Njoftime nga DPUMM | Vërejtje, njoftime | Punë me palë, ankesa , kërkesa | Lendet e pranuar | Barazim i të hyrave nga pranimet teknike te lokaleve afariste | Lënd te ekzekutuara nga Gjykata | Konfiskim i targave, librezës dhe kthim | Inspektim i bizneseve pa pranime teknike | Menaxhim i tregjeve | Aktivendime, ndalesa, urdhëresa | Inspektime për leje Mjedisore Komunale | Inspektim me polici | Inspektim i bizneseve pa regjistrim |
|-------------|-------------------|--------------------------|-----------------|----------------|--|-----------------------|--------------------|--------------------|--------------------------------|------------------|---|---------------------------------|---|--|---------------------|---------------------------------|--|---------------------|-------------------------------------|
| Biznesi     | 122               | 14                       | 5               |                |  |                       |                    |                    | 57                             | 8                | 175€  |                                 |   | 8  | 12                  | 9                               |  | 5                   | 4                                   |
| Ambienti    | 20                | 8                        |                 |                |  |                       |                    | 2                  | 9                              |                  |   |                                 |   |  |                     |                                 | 1                                      |                     |                                     |
| Ndërtimi    | 74                | 26                       |                 |                | 2  | 3                     | 13                 |                    |                                | 21               |   | 2                               |   |  |                     | 7                               |  |                     |                                     |
| Trafiku     | 46                | 9                        |                 |                |  |                       |                    | 10                 | 13                             |                  |   |                                 | 2                                       |  | 12                  |                                 |  |                     |                                     |
| Gjithsej    | 258               | 53                       | 5               |                | 2  | 3                     | 13                 | 12                 | 79                             | 29               | 175€  | 2                               | 2                                       | 8  | 24                  | 16                              | 1                                      | 5                   | 4                                   |

## **DISKUTIMET PUBLIKE**

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

## **TAKIME TË TJERA**

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

## **SFIDAT**

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

## **REKOMANDIMET**

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.

